



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 450 Prot.

Tiranë, më 28.03 2019

**VENDIM Nr. 76 datë 18.03.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, datë 18.03.2019, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Bushat (Shkodër)" 2019*, drejtuar nga Prof.Asoc. Saimir Shpuza (IA) dhe Prof. Piotr Dyczek, Universiteti i Varshavës, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Bushat (Shkodër)" 2019*, drejtuar nga Prof.Asoc. Saimir Shpuza (IA) dhe Prof. Piotr Dyczek, Universiteti i Varshavës, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - Vazhdimi i dokumentimit të siteve në territorin e Shkodrës.
  - Gërmim në disa pika në kodrën e Bushatit. Ky gërmim shihet si vazhdim i punës së bërë vitin e kaluar përsa i takon rilevimit të strukturave që duken në sipërfaqe, kryerjes së survejit gjeofizik në një pjesë të sitit dhe zbulimit të portës jugore të qytetit.
  - Gërmimi fokusohet në 4 pika të kodrës dhe do të ketë si qëllim identifikimin dhe datimin e disa prej strukturave që dallohen në sipërfaqe si dhe të japë një kuadër kronologjik me të qartë për sitin.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2019.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR  
ELVA MARGARITI  
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO**

A handwritten signature in blue ink, enclosed within a large, stylized blue oval.